



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja **d** dhe nenit 14, paragrafi **1** i Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15, qershor 2008), nenit 21, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 i Ligjit nr. 06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 10/03, prill 2019), nenit 24, paragrafi 2 të Rregullores QRK, nr. 09/2020, për përcaktimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, nenit 33.2, shkronja **a**, nenit 34.1 shkronja **d** të Statutit të Komunës së Prishtinas, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010 dhe kërkesës nr. 13-353/01-83468/22, dt. 15.04.2022, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 28.04.2022, mori këtë

V E N D I M
PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS
MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME-POLICISË SË KOSOVËS

- I.** **MIRATOHET** propozimi i Kryetarit të Komunës për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër Ministrisë së Punëve të Brendshme – Policisë së Kosovës.
- II.** Prona e paluajtshme e dhënë në shfrytëzim, e cekur në pikën I të këtij vendimi, është:
 1. Objekti i vendosur në parcelën kadastrale nr. P-71914059-06144-1, Zona kadastrale Prishtinë, në sipërfaqe prej 2410 m², Komuna e Prishtinës.
 2. Parcela kadastrale nr. P-71914059-06143-1, Zona kadastrale Prishtinë, në sipërfaqe prej 468 m², Komuna e Prishtinës.
 3. Parcela kadastrale nr. P-71914059-06142-1, Zona Kadastrale Prishtinë, në sipërfaqe prej 787 m², Komuna e Prishtinës, i cili shërben për nevojat e Stacionit Policor “Veriu” në Prishtinë.
- III.** Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës, të cekur në pikën II të këtij vendimi, është dhënia në shfrytëzim e objektit të Policisë së Kosovës për dislokimin e personelit nga objekti dhe pajisjet e Stacionit Policor “Veriu” në Prishtinë.
- IV.** Afati kohor për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, të cekur në pikën II të këtij vendimi, është për tri (3) vjet, duke e ruajtur të drejtën e ndërprerjes së kontratës në raste specifike.

- V. Prona e paluajtshme e cekur në pikën II të këtij vendimi jepet në shfrytëzim pa kompensim.
- VI. Mënyra dhe kushtet e shfrytëzimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe përfaqësuesit të shfrytëzuesit.
- VII. Prona e paluajtshme komunale që jepet në shfrytëzim, e përshkruar në pikën II të këtij vendimi, duhet të evidentohet në librat kadastralë të Komunës.
- VIII. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtorja e Pronës dhe drejtoritë kompetente të Komunës së Prishtinës.
- IX. Pjesë përbërëse e këtij propozimvendimi janë:
- kërkesa,
 - kopja e planit dhe certifikata e pronës.
- X. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-463/06-94215/22, më 29.04.2022

KRYESUESI I KUVENDIT
Fehmi Kripina



Arsyetim

Ministria e Punëve të Brendshme - Policia e Kosovës në Prishtinë, me shkresën nr. 13-353/01-83468/22, dt. 15.04.2022, ka kërkuar nga Drejtoria e Pronës, shfrytëzimin e pronës komunale, objektin e vendosur në parcelat kadastrale, me nr. 06144-1, ZK Prishtinë, sipërfaqe prej 2410m², Komuna e Prishtinës, nr. 06143-1, ZK Prishtinë, sipërfaqe prej 468m², Komuna e Prishtinës, dhe nr. 06142-1, ZK Prishtinë, sipërfaqe prej 787m², Komuna e Prishtinës.

Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës, sipas këtij propozimi, është dislokimi i personelit nga objekti dhe pajisjet e Stacionit Policor "Veriu" në Prishtinë.

Afati kohor për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, të cekur në pikën II të këtij propozimi, është për tre (3) vjet, duke e ruajtur të drejtën e ndërprerjes së kontratës në raste specifike. Mënyra dhe kushtet e shfrytëzimit të pronës do të caktohen me kontratë, të lidhur në mes të Kryetarit të Komunës dhe shfrytëzuesit.

Andaj, duke u bazuar në dispozitat ligjore si në pjesën hyrëse të këtij Propozimi, dhe në shkresat e lëndës, u vendos si në dispozitiv të këtij propozimi.